30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa te jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranim të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimi përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të porealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësitë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 206-23-10017-5-2-1/C473

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Neni. Nr.</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës për kohëzgjatjen e periudhës prej 90 ditë.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjër në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: <ul style="list-style-type: none"> (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë: brenda 5 ditëve pas nënshkrimit të kontratës
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë max. 50 ditë.
Dëmet e likuiduara	19.1	<p>Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë.</p> <p>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.</p>

Regjistri i punës	20.1	Ditari Ndërtimor, Libri i Punës, Raportet periodike (sipas menaxherit te kontratës).
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është: Caktohet me vendim nga ZKA i MSH-se.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: Nuk aplikohet.
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: max. 10% e çmimit final të Kontratës. Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit te deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 te KPK. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar “me kërkesë”. Shuma e parave te mbajtura do te mbahet gjate tere periudhës se defekteve.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë max. 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës (sipas Planit për Menaxhimin e Kontratës).
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është: 5 vite
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është <i>[shëno përqindjen]</i> .
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për ndërmjetësim pranë Ministrisë se Drejtësisë.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

PARAMASA PËR KRYERJEN E PUNËVE

Projektimi per funksionalizimin e Repartit Pediatrik ne Spitalin e Pergjithshem ne Mitrovice

Vërejtje: Pasi që demolimi dhe renovimi është paraparë të bëhet në pjesen e jashtme dhe te mbrendshme të objektit sipas projektit, gjatë demolimit dhe renovimit duhet të bëhet izolimi dhe kufizimi I zonës së caktuar për demolim dhe renovim në mënyrë që të mos pengohet mbarëvajtja funksionale e objekteve perreth.

Gjate puneve te demolimit punekryesi duhet te kete kujdes qe te mos demtoj pjese tjera te cilat nuk jane parapare per demolim. Cdo demtim nga punekryesi, obligohet qe ta riparoj dhe ta kthej ne gjendje fillestare.

Pas perfundimit te puneve PUNEKRYESI eshte i obliguar qe te rregulloj, nivelizoj, pastroj dhe ti kthej si ne gjendje fillestare te gjitha siperfaqet e jashtme te cilat jane demtuar gjate procesit te punimeve.

Sqarim: Ne te gjitha pozicionet parashihet fFURNIZIMI ME MATERIAL, KRYERJA E PUNEVE dhe SKELERIA E NEVOJSHME. Tek punet demoluese, mbeturinat te dergohen ne deponi ku e cakton komuna, kurse materialet qe mund te duhen ne te ardhmen, lokacionin e deponimit e cakton organi mbikeqyres.

Gjate germimit, materiali i pa-nevojshem te dergohet ne deponin qe e cakton komuna.

A ARKITEKTURA

I. PUNËT PREGADITORE DHE DEMOLUESE

PUNET DEMOLUESE:

Gjate demolimit te objektit, te meren masat e sigurise, te kihet kujdes qe te mos lendohet ndonje punetor apo pale tjeter, te mos demtohet ndonje objekt afer i cili nuk eshte i parapare te demolohet, te mos demtohen makineri e automjete. Gjate demolimit te behet vazhdimisht ujitja, nese eshte e nevojshme qe te mos shkaktohet shume pluhur. Materiali qe transportohet jasht te transportohet sigurt, te deponohet ne vende legjitime te caktuara nga komuna, gjate transportit te mos zhyten rruget e qytetit etj.

Poz.I	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
I.1	PUNET PREGADITORE				
I.1.1	Vendosja e tabelave dhe shenjave informuese per kantierin e ndertimit si dhe per zonat e rrezikshme.	cope	2.00	€ 300.00	€ 600.00
I.1.2	Sjellja e makinerise punuese dhe pergaditja e kompanise per fillim te puneve.	cope	1.00	€ 500.00	€ 500.00
I.1.3	Preventivi dhe masat mbrojtese te strukturave egzistuese qe nuk demolohen (dyer; dritare; mure ansore; radiator, etj). Realizohet me mbeshtjellja plastike PVC, gjeotekstil 200gr/m2 dhe materiale mbeshtetese per mbajtje (listela, traje druri, etj.) sipas nevojës.	m ²	1500.00	€ 1.00	€ 1,500.00
PUNET PREGADITORE					€ 2,600.00

I.2	PUNET E DEMOLIMIT					
I.2.1	Demolimi dhe largimi i kubezave te betonit dhe strukturave tjera ekzistuese ne siperfaqet ku do te ndertohen ashensori, erembrojtjesit dhe shkallet emergjente. (Preventivi dhe konzervimet; hapja e pllakave; dritare; radiator me instalime; etj.).	m ²	55.00	€ 3.00	€ 165.00	
I.2.2	Demolimi dyshemese ekzistuese nga poliuretani dhe te gjitha shtresave deri ne pllaken nga betoni i armuar, duke perfshire edhe demolimin e instalimeve qe kalojne neper dysheme dhe lajsnet kendore. <i>Materialet e rrenuara apo te demontuara e te cilet nuk ka nevojte te ruhen (te deponohen ne nje vend qe e cakton organi mbikeqyres) atehera ato te transportohen jasht kantierit te ndertimit, te hudhen ne deponi mbeturinash, ne nje lokacion ku e cakton komuna, nese duhet te paguhet per hudhje te materialit te rrenuar, kjo ngarkes financiare bie mbi OE.</i>	m ²	846.00	€ 5.00	€ 4,230.00	
I.2.3	Demolimi i teresishem i fasades se jashtme termike. Geryerja duhet te behet me makineri adekuate, dhe te jete sa me e madhe thellesia e geryerjes deri ne shtresen termoizoluese/Stiropor. Gjate demolimit duhet te kete kujdes te shtuar qe te mos demtohet shtresa e stiroporit. Cdo demtim i panevojshem duhet te sanohet nga OE. <i>Materialet e rrenuara apo te demontuara e te cilet nuk ka nevojte te ruhen (te deponohen ne nje vend qe e cakton organi mbikeqyres) atehera ato te transportohen jasht kantierit te ndertimit, te hudhen ne deponi mbeturinash, ne nje lokacion ku e cakton komuna, nese duhet te paguhet per hudhje te materialit te rrenuar, kjo ngarkes financiare bie mbi OE.</i>	m ²	506.20	€ 3.00	€ 1,518.60	
I.2.4	Geryerja e shtreses se suvatimit dhe gletit neper mure dhe tavane ne vendet ku eshte i demtuar. Geryerja duhet te behet me makineri adekuate, dhe te jete sa me e madhe thellesia e geryerjes deri ne muret ekzistuese nga tullat/bllokat. Gjate demlimit te suvatimit duhet te kete kujdes te shtuar qe te mos demtohen muret nga tullat/bllokat. <i>Materialet e rrenuara apo te demontuara e te cilet nuk ka nevojte te ruhen (te deponohen ne nje vend qe e cakton organi mbikeqyres) atehera ato te transportohen jasht kantierit te ndertimit, te hudhen ne deponi mbeturinash, ne nje lokacion ku e cakton komuna, nese duhet te paguhet per hudhje te materialit te rrenuar, kjo ngarkes financiare bie mbi OE.</i>	m ²	447.00	€ 1.00	€ 447.00	
I.2.5	Demontimi i pllafonit te strehes tek hyrja (nenkonstruksioni per tavan, hunter douglas) ne pjesen ku do te montohet konstruksioni i celikut per ashensor. <i>Materiali i cili mund te perdoret prap duhet te ruhet ne nje vend te caktuar nga organi mbikeqyres ne menyre qe te mos demtohet.</i> <i>Materialet e rrenuara apo te demontuara e te cilet nuk ka nevojte te ruhen (te deponohen ne nje vend qe e cakton organi mbikeqyres) atehera ato te transportohen jasht kantierit te ndertimit, te hudhen ne deponi mbeturinash, ne nje lokacion ku e cakton komuna, nese duhet te paguhet per hudhje te materialit te rrenuar, kjo ngarkes financiare bie mbi OE.</i>	m ²	7.00	€ 100.00	€ 700.00	

1.2.6	Demontimi i fushave te qelqit tek mbindricimi ne atrium, perdesira rami ekzistues ruhet. - gjeresia e profilit: 50 mm - thellesia montuese: 125 mm koefic. i tr. termik i profilit: $U_f=1,6W/m^2K$ xhamat: 6mm 16mm 4.4.1mm low-E mbushje me argon Ne cmim te llogaritet edhe skelet dhe mjetet tjera te nevojshme per qasje ne vendin e punes. <i>Materialet e rrenuara apo te demontuara e te cilet nuk ka nevojte te ruhen (te deponohen ne nje vend qe e cakton organi mbikeqyres) atehere ato te transportohen jasht kantierit te ndertimit, te hudhen ne deponi mbeturinash, ne nje lokacion ku e cakton komuna, nese duhet te paguhet per hudhje te materialit te rrenuar, kjo ngarkes financiare</i>	cope	24.00	€	50.00	€	1,200.00
1.2.7	Demolimi i shtresave perreth daljes per mirembajtjen e kulmit. Ne cmim te llogaritet edhe skelet dhe mjetet tjera te nevojshme per qasje ne vendin e punes.	m ²	2.00	€	50.00	€	100.00
	Demontimi i fasadave gjysem-strukturale: gjeresia e profilit: 50 mm thellesia montuese: 125 mm koefic. i tr. termik i profilit: $U_f=1.6 W/m^2K$ xhamat: 6*12*6 low-E mbushje me argon						
1.2.8	Pos F-01, 5.30 x 6.21 m'	cope	1.00	€	100.00	€	100.00
1.2.9	Pos F-02, 2.77 x 6.21 m'	cope	1.00	€	100.00	€	100.00
	Demontimi i vitrinave te brendshme: -thellesia montuese: 50 mm xhami: i lameluar dhe temperuar 6*6 fllot						
1.2.10	V-01 280 x 3.17 cm'	cope	1.00	€	80.00	€	80.00
1.2.11	V-02 280 x 320 cm'	cope	1.00	€	80.00	€	80.00
1.2.12	V-03 226' x 317 cm'	cope	1.00	€	80.00	€	80.00
1.2.13	V-04 226 x 320 cm'	cope	1.00	€	80.00	€	80.00
	Demontimi i krahut te dyerve te brendshme, transporti per prerjen/shkurtimin e lartesis se krahut te deres dhe mbyllja me folie adekuat e pjeses ku eshte prere dera: -trashesia e krahut: 50 mm thellesia montuese: 125 mm -Rw:27 dB deri 32 dB, sipas DIN 4109 finishi: HPL <i>gashet e montura PU, Protect</i>						
1.2.14	D-01 137 x 317 cm'	cope	17.00	€	10.00	€	170.00
1.2.15	D-02 88.5 x 214 cm'	cope	9.00	€	10.00	€	90.00
	Demontimi i krahut te dritares ne Pos F-03						
1.2.16	DR-01 133 x 85 cm'	cope	1.00	€	10.00	€	10.00
1.2.17	Demontimi me kujdes i dollapeve neper dhomat e pacienteve ne katin I, me dimensione 240x60 nme lartesi h=3.20 m'. Dollapat duhet te ruhen ne nje vend te sigurte, ne menyre qe te mos demtohen. Ne cmim te kalkulohet edhe rimontimi i tyre pas finalizimit te te gjitha puneve renovuese.	cope	6.00	€	10.00	€	60.00
PUNET E DEMOLIMIT						€	9,210.60
I. PUNËT PREGADITORE DHE DEMOLUESE						€	11,810.60
2. PUNËT E RENOVIMIT							
Poz.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma		
2.1	PUNET E DHEUT						

2.1.1	<p>Germimi I dheut te kategorise III dhe IV me makineri adekuate ne pjesen ku do te ndertohet ashensori, me thellesi 1.8 m.</p> <p><i>Verejtje: gjate germimit duhet te kete kujdes te mos demtohen themelet, pusetat dhe instalimet tjera te cilat gjinden ne pjesen qe duhet germuar.</i></p> <p><i>Duke mos pase informata rreth thellesise se themeleve, thellesia e germimit eshte mare e perafert dhe kalkulimi i sasive eshte bere me kuote te perafert. Thellesia e sakte e germimit do te meret pas fillimit te germimit, ku edhe do te caktohet thellesia e sakte nga organi mbikqyres.</i></p>	m ³	14.50	€ 10.00	€ 145.00
2.1.2	<p>Germimi I dheut te kategorise III dhe IV me makineri adekuate ne pjesen ku do te ndertohet erembrojtesi edhe shkallet emergjente, me thellesi 0.6 m¹.</p> <p>Ne cmim te kalkulohet edhe rregullimi i kanalit te germimit me dore dhe transporti i dheut deri ne deponi.</p> <p><i>Verejtje: gjate germimit duhet te kete kujdes te mos demtohen themelet, pusetat dhe instalimet tjera te cilat gjinden ne pjesen qe duhet germuar.</i></p>	m ³	17.70	€ 10.00	€ 177.00
PUNET E DHEUT					€ 322.00

2.2		PUNET E ZHAVORIT				
2.2.1	Furnizimi me material si dhe shtruarja dhe ngjeshja e shtreses se zhavorit sipas fraksioneve te parapara me projekt 0-63mm me trashesi min $\tau=20$ cm ne gjendje te ngjeshur, nen pllakat erembrojtetit, ashensorit dhe shkalleve emergjente. Moduli i ngjeshies 40 MPa.	m ³	7.60	€ 20.00	€	152.00
2.2.2	Furnizimi me material si dhe shtruarja dhe ngjeshja e shtreses se zhavorit sipas fraksioneve te parapara me projekt 0-31.5 mm me trashesi min $\tau=10$ cm ne gjendje te ngjeshur, nen themele shiritore, pllaken e nivelit +0.00 dhe parter rreth objektit. Moduli i ngjeshies 40 MPa.	m ³	3.80	€ 20.00	€	76.00
					PUNET E ZHAVORIT	€ 228.00
2.3		PUNET E BETONIT				
2.3.1	Furnizimi me material si dhe betonimi i kafazit te ashensorit dhe pllakes se erembrojtetit ($\tau=20$ cm) ne nivelin +0.00, te punohen sipas projektit, me beton C-25/30, qe permban aditiv kunder lageshtise. Ne cmim te kalkulohen edhe pahite e nevoishme.	m ³	6.00	€ 200.00	€	1,200.00
2.3.2	Furnizimi me material si dhe betonimi i pllakes te shkallet emergjente ne nivelin +0.00 ($\tau=20$ cm), te punohen sipas projektit, me beton C-25/30. Ne cmim te kalkulohen edhe pahite e nevoishme.	m ³	3.60	€ 200.00	€	720.00
					PUNET E BETONIT	€ 1,920.00

2.4		PUNET E ARMATURES DHE KONSTRUKSIONIT METALIK			
		Çeliku për armaturë do të jetë i brinjëzuar përveç nëse ipen indikacione tjera nga organi			
2.4.1	Furnizimi me material, prerja dhe lakimi i armaturave S-500, sipas detajeve të armimit si dhe armaturave rrjete të parapara me projekt.	kg	1100.00	€ 1.80	€ 1,980.00
2.4.2	Furnizimi me material dhe montimi i konstruksionit të çelikut të ashensorit. Ne cmim të kalkulohet edhe ngjyrosja e konstruksionit me ngjyre adekuate (1 baze dhe 1 shtrese ngjyre), saldimet, ankerat, pllakat ankeruese dhe të gjitha elementet lidhese të nevojshme.	kg	980.00	€ 2.50	€ 2,450.00
2.4.3	Furnizimi me material dhe montimi i konstruksionit të çelikut për shkalletemrgjente. Ne cmim të kalkulohet edhe ngjyrosja e konstruksionit me ngjyre adekuate (1 baze dhe 1 shtrese ngjyre), saldimet, ankerat, pllakat ankeruese dhe të gjitha elementet lidhese të nevojshme. Ne cmim të kalkulohet edhe gardhi i shkallve, mveshjaet anesore si dhe ngjyrosja me ngjyre metalike dyshtresore.	kg	1050.00	€ 1.80	€ 1,890.00
		PUNET E ARMATURES DHE KONSTRUKSIONIT METALIK			€ 6,320.00
2.5		PUNET E HIDROIZOLIMIT			
		KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR PUNËT E HIDROIZOLIMIT			
2.5.1	Furnizimi me material dhe punimi i hidroizolimit në tere pllaken e perdhese, duke përfshirë edhe pllaken e erembrojtës dhe kafazit të ashensorit, me trashësi 2x4 mm, ngjitje me shkrirje termike – flakë, Përputhja/mbi-saldimi i shiritave të membranave të jete min. 10cm. Ne çmimi të parashihet rrafshimi, pastrimi me uje me presion dhe tharja paraprake e sipërfaqeve ku vendoset Hidroizolimi dhe paralyerja me mase "Bitulit"	m ²	438.00	€ 8.00	€ 3,504.00
2.5.2	Furnizimi me material dhe hidroizolimi i daljes për mirembajtjen e kulmit, me trashësi 2x4 mm, ngjitje me shkrirje termike – flakë, Përputhja/mbi-saldimi i shiritave të membranave të jete min. 10cm. Ne çmimi të përfshihet edhe rrafshimi, pastrimi me uje me presion dhe tharja paraprake e sipërfaqeve ku vendoset Hidroizolimi dhe paralyerja me mase "Bitulit", si dhe mjetete nevojshme për çastie në vendin e punës.	m ²	5.00	€ 8.00	€ 40.00
2.5.3	Furnizimi me material si dhe vendosja e hidroizolimit të ftohte, dyshtresor, tek muret ku do të montohen lavamanet shtese.	m ²	10.00	€ 10.00	€ 100.00
		PUNET E HIDROIZOLIMIT			€ 3,644.00

2.6 PUNET E MURATIMIT					
2.6.1	Furnizimi me material si dhe punimi i mveshjeve nga knaufi, te parashihet edhe konstruksioni mbajtes. Me kete parashihet te behet mveshja e konstruksionit te ashensorit dhe elementet tjera te nevojshme, me dy shtresa te knaufit.	m ²	72.00	€ 35.00	€ 2,520.00
PUNET E MURATIMIT					€ 2,520.00
2.7 PUNET E NIVELIZIMIT					
2.7.1	Furnizimi me material dhe punimi i shtreses rrafshuese nen pllake te erembrojtetit dhe nen kafaz te ashensorit me klase te betonit C16/20 me klasë të ekspozimit XC2.	m ³	11.50	€ 50.00	€ 575.00
2.7.2	Furnizimi me material dhe punimi i nivelizimit me estrih me trashësi 5-8 cm në pothuajse të gjitha kthinat e brendshme (sipas projektit), duke përfshirë shtresën ndarëse nga folia e PVC-së dhe shiritin nga polietileni me trashësi 5 mm në kontakt me muret dhe elementet tjera ne kulm si në detaje për pengimin e përcjelljes së zërit struktural. Niveli i estrihut duhet te barazohet me nivelin e pllakave ekzistuese neper nyje sanitare ne objekt, me qellim te nivelizimit te te gjitha siperfaqeve. Në çmim të përfshihet edhe perforcimi me fibra per lidhje. Fugat dilatuese duhet te punohen sipas standardeve te dokumentimit.	m ²	860.00	€ 7.00	€ 6,020.00
2.7.3	Furnizimi me material dhe vendosja e termoizolimit stiropor N4- 5cm (2.5+2.5cm) ne tere siperfaqen e dyshemeve te kthinave ku nuk ka lageshti.	m ²	860.00	€ 3.00	€ 2,580.00
PUNET E NIVELIZIMIT					€ 9,175.00

2.8	PUNET E DYSHEMESE				
2.8.1	<p>Furnizimi me material si dhe montimi: Dyshemeja epokside adekuatë për kthinat e objekteve shëndetësore. Gërryerja dhe pastrimi (me thithese profesionale) i nënshtresës (estrih). Furnizimi dhe punimi i dyshemese epokside në trashësi totale së paku 2,0 mm, me materiale të certifikuar për ambiente (ekologjike). Shtresa baze epokside, punimi i shtresës vetenivelizuese me epoksid duke i hedhur sipër grimcat dekoruese (chipsa). Ngjyra dhe dizajnet nëpër kthinat të përcaktohen nga organi mbikqyrës. Shiriti anësor të punohet nga profili metalik në formë harkore (me rreze ca. 20cm) dhe lartësi 70mm, i lypur për të mbuluar hapësirat e kthina.</p>	m ²	860.00	€ 24.00	€ 20,640.00
				PUNET E DYSHEMESE	€ 20,640.00
2.9	PUNET E QERAMIKES				
2.9.1	<p>Furnizimi me material dhe mveshja e mureve ku do të montohen lavamanet e rinj me pllaka të paglazuar qeramike me dimensione, ngjyrë dhe teksturë të përcaktuar nga organi mbikqyrës. Pllakat duhet të jenë rezistente ndaj rrëshqitjes min.RI 2, rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngricave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit dhe të përshtatshme për frekuentim të madh me këpucë në ambiente publike, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjitja e pllakave të bëhet me ngjitës kualitativ fleksibil dhe hidroizolues, me fuga të gjera 2 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit. Në çmim të përfshihen prerja e pllakave në kënd 45° nëpër këndet e jashtme, si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitar rezistent ndaj mykut.</p>	m ²	8.80	€ 40.00	€ 352.00
				PUNET E QERAMIKES	€ 352.00

2.10		PUNET E SUVATIMIT DHE NGJYROSJES			
2.10.1	Furnizimi me material dhe suvatimi i mureve me suva te gatshme të mbrendshme dhe tavaneve ne vendet ku eshte demoluar, , te punohet sipas standardeve duke perdorur shtresat e nevojshme, te perdoret rrjete gjate suvatimit si dhe kendet adekuate. Ne cmim te kalkulohet edhe permiresimi i kendeve te nevojshme rreth dyerve dhe dritareve, si dhe pjeseve tjera ku ka pasur intervernime.	m ²	447.00	€ 3.00	€ 1,341.00
2.10.2	Furnizimi me material si dhe gletimi i mureve te brendshme dhe tavaneve ku eshte demoluar, te punohet sipas standardeve me te gjitha materialet-shtresat tjera adekuate. Ne cmim te kalkulohet edhe permiresimi i kendeve te nevojshme rreth dyerve dhe dritareve, si dhe pjeseve tjera ku ka pasur intervernime.	m ²	447.00	€ 2.00	€ 894.00
2.10.3	Furnizimi me material, patinimi dhe ngjyrosja e mureve të objektit ne te gjitha nivelet me ngjyrë dy komponentale me nuanca sikur ato ekzistuese, duke përfshirë edhe lyerjen paraprake me "Primer" adekuat). Norma EN 13300	m ²	2042.00	€ 2.00	€ 4,084.00
2.10.4	Furnizimi me material, patinimi dhe ngjyrosja e tavaneve të objektit me ngjyrë dy komponentale, duke përfshirë edhe lyerjen paraprake me "Primer" adekuat). Norma EN 13300	m ²	922.00	€ 2.00	€ 1,844.00
PUNET E SUVATIMIT DHE NGJYROSJES					€ 8,163.00

2.11		PUNET E KULMIT					
		Kuonstruksioni dhe Mbulesa					
2.11.1	Furnizimi me material si dhe montimi i mbuleses nga llamarina e valezuar mbi shkallet emergjente.	m ²	18.00	€	20.00	€	360.00
PUNET E KULMIT						€	360.00

2.12	PUNET E ZDRUKHTARISE				
	Furnizimi me material, transporti dhe montimi i fasadave gjysem-strukturale: -gjerësia e profilit: 50 mm -thellessia montuese: 125 mm -koefic. i tr. termik i profilit: $U_f=1.6 \text{ W/m}^2\text{K}$ -xhamat: 6*12*6 low-E -mbushje me argon				
2.12.1	Pos F-01, 3.06 x 6.21 m'	m ²	19.00	€ 300.00	€ 5,700.78
2.12.2	Pos F-02, 2.77 x 6.21 m'	m ²	17.20	€ 300.00	€ 5,160.51
	Furnizimi me material, transporti dhe montimi i vitrinave te brendshme: -thellessia montuese: 50 mm -xhami: I lameluar dhe temperuar 6*6 flot				
2.12.3	V-01 306 x 621 cm'	m ²	19.00	€ 150.00	€ 2,850.39
